

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	656-25-2189-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **Mbështetje profesionale për Hartimin e dokumenteve të Planifikimit të PZHK-së, HZK-së dhe rregullorja e bonuseve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Geo&Land sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bardhyl Qaushi C15/11

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

038739193

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vesa Mekolli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@geoland-kosova.com

(Adresa elektronike)

09/06/2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datë 20.03.2025

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 14.04.2025

Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi ekonomikisht me i favorshëm

Kërkesa për rishqyrtim 27.05.2025

Vendim për refuzim ndaj kërkesës për rishqyrtim me datë 30.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 27.05.2025 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ku kemi pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha argumentet tona se AK duke mos ofruar qasje në dokumentet baze të OE të shpallur fitues ka vepruar në kundërshtim me LPP.

Me datë 30.05.2025 AK ka publikuar vendimin përmes të cilit ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, duke e vlerësuar si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e pretenduara sipas LPP

- ✓ *Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar),*
 - Neni 6
 - Neni 7
 - Neni 59.4
 - Neni 68
 - Neni 69.
 - Neni 72.4
 - Neni 72.5
 - Neni 108/A

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 20.03.2025, Komuna e Ferizajt ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ndaj operatorit ekonomik i SHPALLUR FITUES, në kuadër të një aktiviteti të prokurimit për të cilin edhe Ne si OE kemi konkurruar me ofertë të përmbushur në përpikëri sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit (FDT) dhe Termave të Referencës (TOR).

Pas shpalljes së vendimit për dhënien e kontratës, me datë 22.05.2025, kemi dorëzuar një kërkesë zyrtare për qasje në dokumentet përkatëse të vlerësimit, në përputhje me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Kjo kërkesë është pranuar dhe konfirmuar përmes emailit nga autoriteti kontraktues. Me datë 27.05.2025 kemi dërguar kërkesë për rishqyrtim e cila ne kundërshtim me LPP nuk është arsyetuar por vetëm është refuzuar me datën 30.05.2025

Pretendimi nr. 1

Megjithatë, gjatë dorëzimit të dokumenteve, AK ka shkelur haptazi parimet e transparencës dhe barazisë në trajtim, duke mos ofruar dokumente esenciale për të mundësuar një shqyrtim real të procesit të vlerësimit dhe përgatitjen e një ankese të bazuar. Këto shkelje përfshijnë:

A) Dokumentet që nuk janë ofruar pa asnjë arsye:

- Procesverbali i vlerësimit teknik dhe financiar me pikët sipas nën-kritereve nga Komisioni vlerësues dhe nënshkrimet përkatëse;
- Procesverbali Komisionit vlerësues i verifikimit të kushteve të kualifikimit (Tekniko-profesionale dhe financiare);
- Deklarata nën betim e OE i SHPALLUR FITUES
- Aneksi i nënshkruar nga OE i SHPALLUR FITUES për të dëshmuar se për cilat pjesë të ofertës është kërkuar konfidencialitet, i cili, sipas AK-së, supozohet se ekziston, por nuk është dorëzuar;
- Vendimi mbi emërimin e komisionit vlerësues
- Dokumentet tjera relevante

B) Dokumentet që nuk janë ofruar fare me arsyetim e kërkesës për konfidencialitet:

- Propozimi teknik dhe metodologjia e realizimit të projektit (80% e pikëve të vlerësimit)

- Dëshmitë financiare dhe tatimore (deklaratat e ATK, certifikata të pagesave);

Është fakt i dokumentuar se AK, përmes një vendimi të mëvonshëm, ka refuzuar qasjen në dokumentet thelbësore duke u thirrur në supozime për konfidencialitet, pa paraqitur asnjë dëshmi ligjore që OE i SHPALLUR FITUES ka kërkuar një gjë të tillë. Kjo përbën shkelje flagrante të:

- Nenit 72.1 dhe 72.2 të Ligjit për Prokurimin Publik;
- Parimit të transparencës së garantuar në nenin 7 të LPP-së;
- Vendimit të OSHP-së nr. 425/22, ku është theksuar se *“autoriteti kontraktues nuk mund të kufizojë qasjen në dokumente që janë thelbësore për procesin e ankesës, përveç nëse ekziston kërkesë e qartë e OE-së dhe kjo është e justifikuar ligjërisht.”*

Duke mos ofruar qasje në këto dokumente, AK jo vetëm që ka pamundësuar kontrollin real mbi procesin e vlerësimit, por na ka privuar ne si OE konkurues nga ushtrimi efektiv i të drejtës për ankesë të bazuar, në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së.

Sikur të ishte ofruar dokumentacioni i kërkuar, ne do të kishim mundur të vërtetojmë që OE i SHPALLUR FITUES:

- Nuk ka dëshmuar qarkullimin financiar minimal prej 1,000,000 EUR për periudhën e kërkuar;
- Ka fituar pikë në vlerësimin Teknik si dhe ate financiar në kundërshtim me formulën standarde për vlerësim teknik/financiar, pasi oferta e tij është për periudhë jo përputhëse me FDT.

Mos ofrimi i këtyre dokumenteve nuk është arsyetuar nga AK, përveçse në një rast, në të cilin është paraqitur një vendim administrativ për refuzimin e qasjes me arsyetimin e ruajtjes së sekretit afarist. Megjithatë, as në këtë vendim dhe as në dosjen e prokurimit nuk ekziston **asnjë kërkesë zyrtare nga OE i SHPALLUR FITUES për konfidencialitet**, në kundërshtim me **nenin 72.4 dhe 72.5 të LPP-së**, që kërkojnë që çdo kërkesë për mbrojtje të të dhënave të karakterit konfidencial të paraqitet me shkrim dhe të specifikojë qartë pjesët që përbëjnë sekret afarist.

Ky veprim i Autoritetit Kontraktues, pra **refuzimi për të ofruar dokumentacion të domosdoshëm pa bazë ligjore dhe në mungesë të kërkesës për konfidencialitet**, përbën shkelje serioze të parimeve themelore të prokurimit publik, të garantuara në:

- **Neni 6 i LPP** – që përcakton parimin e transparencës dhe kërkon që të gjitha procedurat të jenë të hapura për shqyrtim nga OE pjesëmarrës;
- **Neni 7 i LPP** – që garanton trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- **Neni 72.1 dhe 72.2 i LPP** – që sanksionon të drejtën e OE-ve për qasje në dokumente të prokurimit;
- **Neni 108/A i LPP** – që garanton të drejtën për ankesë të informuar.

Veprimi i Autoritetit Kontraktues për të kufizuar në mënyrë arbitrare dhe të paarsyeshme qasjen në dokumentet thelbësore për përgatitjen e kësaj ankese përbën një shkelje serioze të parimeve bazë të prokurimit publik, siç janë transparenca, barazia dhe llogaridhënia. Këto veprime jo vetëm që përbëjnë kufizim të së drejtës ligjore për të ushtruar ankesë të mbështetur në prova, por gjithashtu krijojnë hije të rënda dyshimi mbi ligjshmërinë e procesit të vlerësimit dhe integritetin e vendimit për dhënie të kontratës.

Kufizimi i qasjes në dokumente i ka pamundësuar GEO&LAND të kuptojë arsyetimin ligjor dhe teknik të përzgjedhjes së ofertës fituese dhe të evidentojë në kohë mospërputhjet e saj me kriteret ligjore. Kjo përbën shkelje të:

- Nenit 72.1 të LPP-së, që garanton të drejtën për të marrë njoftim dhe dokumentacion përkatës lidhur me vendimin e dhënies së kontratës;
- Nenit 72.2 të LPP-së, që sanksionon të drejtën e operatorit për të pasur qasje në dokumente për të ushtruar të drejtën e ankesës;
- Nenit 6 të LPP-së, mbi transparencën në të gjitha fazat e prokurimit publik;
- Nenit 7 të LPP-së, mbi trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve;
- Nenit 108/A të LPP-së, që garanton të drejtën për ankesë të informuar dhe të bazuar në dokumente.

Sipas praktikës normative të OSHP

Në vendimin **nr. 575/22**, OSHP ka vendosur se:

"Mosofrimi i dokumenteve esenciale për rivlerësim, si procesverbalet, dëshmitë tatimore dhe ofertat teknike/financiare, në mungesë të kërkesës formale për konfidencialitet, përbën shkelje të të drejtës së OE për ankimin e informuar dhe barazi në procedurë."

Në **vendimin nr. 229/21**, OSHP ka konstatuar se:

"Autoriteti kontraktues ka detyrim të ofrojë qasje të plotë në të gjitha dokumentet që ndikojnë në vendimin për dhënie të kontratës, përfshirë ofertat teknike, financiare dhe vlerësimet përkatëse, përveç rasteve kur ekziston vendim formal mbi konfidencialitetin."

Në **vendimin nr. 044/22**, OSHP ka konstatuar:

"Mosofrimi i procesverbaleve të vlerësimit teknik dhe mungesa e kërkesës së dokumentuar për konfidencialitet përbëjnë kufizim të paarsyeshëm të së drejtës së ankesës."

Këto vendime krijojnë praktikë të konsoliduar sipas së cilës AK nuk mund të kufizojë qasjen në dokumente pa kërkesë të shkruar, specifike dhe vendim administrativ të miratuar, dhe që çdo kufizim i tillë bie ndesh me LPP dhe cenon themelet e konkurrencës së ndershme.

Kështu, veprimet e AK bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

- **Nenin 6 të LPP** – parimi i transparencës;

- **Nenin 7 të LPP** – parimi i trajtimit të barabartë;
- **Nenin 72.1 dhe 72.2 të LPP** – e drejta për qasje në dokumente;
- **Nenin 108/A të LPP** – e drejta për ankesë të informuar dhe efektive.

Një nga kushtet thelbësore të kualifikimit sipas dosjes së tenderit dhe Ligjit për Prokurimin Publik (neni 69.1.2) është që operatori ekonomik të dëshmojë përvojë të mëparshme relevante përmes kontratave të ngjashme të përfunduara gjatë tre viteve të fundit, në vlerë të përgjithshme prej minimum 550,000 €. Përveç kësaj, FDT kërkon që të dëshmohet një qarkullim financiar për tri vitet e fundit prej të paktën 1,000,000 € për periudhën 2022–2024.

Pretendimi nr.2

Ne kete procedure te tenderit, OE i SHPALLUR FITUES ka paraqitur nje numër te referencave, mirëpo nga dokumentet e ofruara (të pjesshme dhe të pa plota) rezulton se:

- Referencat nuk përmbajnë të gjitha elementet e detyrueshme sipas nenit 69.1.2 të LPP-së, siç janë: data e fillimit dhe përfundimit të kontratës, përshkrimi teknik i projektit dhe vlera kontraktuale e konfirmuar.
- Në disa raste, periudhat e kontratave tejkalojnë 36 muaj, gjë që nuk është praktikë në kontratat publike në Kosovë dhe sjell dyshim për vlefshmërinë e të dhënave.
- Ne rastet kur Referencat nuk janë te plota, mungojnë dokumentet shoqëruese si certifikata të kryerjes së shërbimeve apo pranimit përfundimtar, të cilat janë esenciale për të dëshmuar se projektet janë realizuar me sukses.

Këto mungesa e bëjnë të pamundur verifikimin e vlerës së përgjithshme prej 550,000 € dhe për rrjedhojë, OE i SHPALLUR FITUES nuk i plotëson kriteret minimale të kualifikimit.

Me qene se Procesverbali i vlerësimit nuk është ofruar për shqyrtim dhe nuk është dokumentuar se Komisioni ka bërë verifikim faktik të vlerave të referencave. AK nuk ka sqaruar se cilat referencia janë konsideruar valide dhe mbi çfarë baze është konstatuar përmbushja e pragut prej 550,000 €.

Pretendimi nr. 3

Sipas FDT, operatori duhet të dëshmojë një qarkullim vjetor mesatar prej së paku 1,000,000 € për tri vitet e fundit sipas nenit 68 të LPP. AK nuk ka ofruar asnjë dokument që dëshmon këtë kriter për OE i SHPALLUR FITUES. Në mungesë të deklaratave tatimore zyrtare nga ATK, bilanceve të audituara apo pasqyrave financiare të nënshkruara nga auditor i licencuar, ky kriter mbetet i papërmbushur.

Duke mos pasur këto dëshmi, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, i cili e obligon autoritetin kontraktues të përjashtojë një ofertë që nuk përmbush specifikimet thelbësore të dosjes së tenderit.

Në mungesë të kësaj procedure, vendimi për shpalljen fitues të OE i SHPALLUR FITUES është i pambështetur dhe i njëanshëm.

Sipas praktikës normative të OSHP

Në vendimin **nr. 0661/23**, OSHP ka konstatuar se referencat që nuk përmbajnë të gjitha elementet ligjore të nenit 69.1.2 të LPP-së, si datat e fillimit/mbarimit dhe vlera e kontratës, janë të pavlefshme dhe nuk mund të përdoren për të dëshmuar përvojën e kërkuar.

Në vendimin **nr. 0984/22**, OSHP ka theksuar se mungesa e dëshmive për qarkullim financiar sipas kërkesës së FDT është bazë për skualifikim të drejtpërdrejtë të operatorit, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

Duke qenë se referencat e OE i SHPALLUR FITUES nuk i përmbushin kushtet ligjore dhe mungojnë dokumentet që dëshmojnë qarkullimin e kërkuar financiar, konsiderojmë se shpallja e këtij OE si fitues është në kundërshtim me nenin 69, nenin 59.4 dhe nenin 6 të LPP-së, dhe për pasojë kërkojmë që:

- Të konstatohet pavlefshmëria e referencave të paraqitura;
- Të vlerësohet se kriteri për përvojë dhe qarkullim financiar nuk është përmbushur;
- OE i SHPALLUR FITUES të përjashtohet nga vlerësimi i mëtejshëm si ofertë e papranueshme ligjorisht.

Pretendimi nr. 4

Plani Dinamik i Papërputhshëm – Devijimi nga Termat e Referencës dhe Shkelja e Nenit 59.4 të LPP-së

Një nga komponentët kyç në vlerësimin e ofertës teknike është përputhshmëria e planit dinamik të zbatimit me kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës (TOR), përkatësisht në Shtojcën 3 të dosjes së tenderit. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar qartësisht që:

- Kohëzgjatja e projektit të jetë **minimumi 36 muaj**;
- Të përfshihen **faza të ndara dhe të qarta**: analiza fillestare, konsultim publik, miratim institucional, zbatim për një vit fiskal, trajnime dhe vlerësim të rezultateve.

1. Përmbajtja e planit të paraqitur nga OE i SHPALLUR FITUES

Plani dinamik i paraqitur nga OE I SHPALLUR FITUES përfshin një kohëzgjatje prej **vetëm 19 muajsh**, duke anashkaluar kërkesën thelbësore për 36 muaj të mbështetjes teknike dhe implementimit të rregullores mbi mekanizmin e bonuseve. Ky plan është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Shtojcën 3 të FDT-së dhe nenin 59.4 të LPP-së, i cili përcakton qartë:

“Autoriteti kontraktues përjashton një tenderues nga vlerësimi i mëtejshëm nëse oferta e tij nuk është në përputhje me kushtet dhe specifikimet esenciale të dosjes së tenderit.”

2. Mospërputhje të strukturuar sipas fazave të projektit

Faza e projektit	Kërkesa nga Shtojca 3	Ofertuar nga OE i SHPALLUR FITUES	Mospërputhja
Kohëzgjatja e projektit	36 muaj	19 muaj	17 muaj me pak
Analiza e rregullores dhe hartimi teknik	3–4 muaj	2 muaj	Jo e mjaftueshme
Konsultimi publik	Minimum 2 muaj	1 muaj	Reduktim joreal
Miratimi nga MMPHI dhe KK	2–3 muaj	1 muaj	Pa kohë për procedurë
Zbatimi i rregullores (pilotim)	12 muaj	6 muaj	Reduktim 50%
Trajnimet për administratën komunale	2 muaj	Mungon	Mungesë
Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve	Minimum 3 muaj	Mungon	Mungesë

Këto devijime thelbësore dëshmojnë se plani i propozuar nga OE i SHPALLUR FITUES nuk është i realizueshëm dhe nuk i përmbush kërkesat minimale të dosjes së tenderit.

3. Pasojat buxhetore dhe vlerësimi financiar i gabuar

Ne kemi ofertuar 488,420 €, duke përmbushur plotësisht kërkesën për kohëzgjatje 36-mujore të paraqitur në planin dinamik, që rezulton në një kosto mujore prej rreth 13,567 €.

OE i SHPALLUR FITUES ka ofertuar 549,500 € për vetëm 19 muaj, me një kosto mujore prej 28,921 €. Nëse kjo ofertë do të projektohej për periudhën e kërkuar (sipas FDT) 36-mujore, ajo do të arrinte në një total prej mbi 1,041,158 €, që është 552,738 € më e shtrenjtë sesa oferta jone.

Ky diferencim i theksuar financiar nënkupton që AK ka favorizuar një ofertë objektivisht më të kushtueshme dhe teknikisht të papërputhshme me kërkesat e tenderit.

Llogaritja e pikëve financiare për OE i SHPALLUR FITUES është bërë në kundërshtim me nenin 7.2 të FDT-së. Për më tepër, përfitimi i pikëve për një periudhë vetëm 19-mujore, ndonëse kërkesa kontraktuale është për 36 muaj, është i pajustificueshëm dhe në kundërshtim të qartë me ligjin.

Sipas praktikës normative të OSHP

Në vendimin **nr. 0661/23**, OSHP ka vendosur përjashtimin e një OE sepse plani i tij dinamik nuk i përmbante të gjitha fazat e kërkuara dhe kohëzgjatja ishte më e shkurtër se ajo e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Në vendimin **nr. 0712/22**, OSHP thekson rëndësinë e zbatimit të fazave të plota dhe zgjatjes kohore të kontratës për të siguruar vlerësim real të ofertave dhe mbrojtje të interesit publik.

5. Përfundim

Bazuar në nenin 59.4 të LPP-së, dhe faktin që plani dinamik është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesat e dokumentacionit të tenderit, kërkojmë që:

- Plani i OE i SHPALLUR FITUES të konsiderohet i papranueshëm;
- Pikët e fituara nga OE i SHPALLUR FITUES për ofertën financiare të rivlerësohen ose të zeroohen;
- OE i SHPALLUR FITUES të përjashtohet nga gara si ofertë joreale dhe teknikisht e papërputhshme me FDT-në.

Pretendimi nr. 5

Anshmëria dhe Diskriminimi në Vlerësimin Teknik

Vlerësimi i ofertave teknike është një nga komponentët më të rëndësishëm të procesit të prokurimit publik dhe duhet të udhëhiqet nga parimi i barazisë, transparencës dhe paanshmërisë, siç përcaktohet në nenin 7 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Në rastin konkret, kemi identifikuar indikacione të qarta të anshmërisë në vlerësim, në favor të OE i SHPALLUR FITUES, në dëm të konkurrencës dhe ofertave të tjera.

1. Mospërputhja me përqindjen e vlerësimit teknik dhe financiar

Sipas dosjes së tenderit, vlerësimi është paraparë të bëhet me 80% për komponentën teknike dhe 20% për ofertën financiare. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka

prezantuar procesverbalin e vlerësimit të pikëve sipas nën-kritereve, që do të mundësonte verifikimin e paanshmërisë dhe drejtësisë në këtë vlerësim.

Kjo mungesë cenon drejtpërdrejt nenin 72.1 të LPP-së, që garanton qasje në dokumentet përkatëse për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

2. Mungesa e transparencës në dokumentacionin e vlerësimit teknik

Në kundërshtim me nenin 6.3 të Rregullores për Dosjen Standarde të Tenderit për Shërbime, nuk është ofruar asnjë informacion për:

- Procesverbalin e ndarjes së pikëve sipas nën-kritereve;
- Komentet e komisionit për secilin kriter teknik;
- Argumentet e AK se perse OE i SHPALLUR FITUES është vlerësuar më larte se ofertuesit e tjerë (NE).

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar të ofrojë dokumentet e mësipërme pa një vendim të qartë të OE për konfidencialitet, duke krijuar dyshim mbi legjitimitetin e vlerësimit.

3. Trajtimi i pabarabartë në interpretimin e kritereve

Ka dyshime të arsyeshme që gjatë vlerësimit teknik janë përdorur standarde të ndryshme për operatorët ekonomikë, duke toleruar mospërputhjet e OE i SHPALLUR FITUES (p.sh. plani dinamik joadekuat) ndërkohë që mund të jenë penalizuar detaje më të vogla në ofertat e tjera.

Kjo përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së që ndalon çdo formë të diskriminimit në prokurim publik:

“Autoritetet kontraktuese do të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.”

Sipas praktikës normative të OSHP

Në vendimin **nr. 0479/22**, OSHP ka sanksionuar një Autoritet Kontraktues për mosofrimin e qasjes në pikët sipas nënkritereve dhe për mungesë të arsytimit në favorizimin e OE fitues.

Në vendimin **nr. 0324/21**, është urdhëruar rivlerësimi i ofertave teknike për shkak të mospërputhjes në zbatimin e kritereve teknike dhe trajtimin joadekuat të ofertuesve.

Pretendimi nr. 6

Deformimi i Konkurrencës përmes Ofertës më të Lartë dhe Shërbimeve më të Pakta

Një nga elementët themelorë të një procedure të drejtë dhe efektive të prokurimit është që konkurrenca të zhvillohet mbi baza të barabarta dhe ofertat të vlerësohen mbi parimin e raportit më të mirë cilësi-çmim, siç përcaktohet në nenin 61 dhe nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Në rastin konkret, kemi një situatë që përbën deformim serioz të konkurrencës dhe dëm buxhetor të drejtpërdrejtë:

1. Krahësimi i ofertave financiare

Operator Ekonomik	Vlera e Ofertës	Kohëzgjatja	Kosto mujore	Kosto e projektuar për 36 muaj
GEO&LAND	488,420 €	36 muaj	13,567 €/muaj	488,420 €
I SHPALLUR FITUES	549,500 €	19 muaj	28,921 €/muaj	1,041,158 €

Për 36 muaj me ritmin e ofertuar prej OE i SHPALLUR FITUES, kostoja do të arrijë mbi **1 milion euro**, që është **552,738 € më shumë** sesa oferta e GEO&LAND për të njëjtën periudhë.

2. Dëmi financiar dhe përfitimi joligjor i pikëve

Për më tepër, oferta financiare e OE i SHPALLUR FITUES është vlerësuar me **17 pikë** nga 20 të mundshme, duke përdorur formulën standarde të vlerësimit sipas LPP.

Por kjo përllogaritje është bërë mbi një **kohëzgjatje të papërputhshme me kontratën** (19 muaj në vend të 36 muajve të kërkuara), gjë që sipas nenit 59.4 të LPP-së përbën mospërputhje esenciale dhe e bën ofertën të papranueshme teknikisht.

Ky vlerësim i rremë financiar i ka dhënë avantazh të pamërituar OE i SHPALLUR FITUES dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të vlerësimit, duke çuar në **deformim të konkurrencës, cenim të barazisë dhe dëmtim të buxhetit publik**.

Ky rast përbën një shkelje të trefishtë të parimeve të LPP-së:

- **Efikasiteti i shpenzimit publik** (neni 6.1);
- **Barazia dhe konkurrenca** (neni 7);
- **Përputhshmëria me kushtet esenciale** (neni 59.4).

Sipas praktikës normative të OSHP

Në **vendimin nr. 0661/23**, OSHP ka konstatuar se mospërputhja e planit dinamik me kohëzgjatjen e kontratës përbën shkak të mjaftueshëm për përjashtimin e ofertës, pavarësisht çmimit apo vlerësimeve tjera.

Në **vendimin nr. 0189/22**, është konstatuar se një ofertë me vlerë të papërputhshme financiarisht dhe pa krahasueshmëri të plotë kohore nuk mund të konsiderohet valide për vlerësim financiar.

Duke u ndërlidhur me faktet e prezantuar me lartë, Autoriteti Kontraktues jo vetëm që ka pranuar një ofertë më të shtrenjtë për një periudhë më të shkurtër dhe me shërbime më të reduktuara, por edhe i ka dhënë pikë të padrejta financiare duke deformuar konkurrencën. Kjo përbën një dëm të drejtpërdrejtë financiar për buxhetin publik dhe një shkelje të rëndë të parimeve të prokurimit të ndershëm.

a. Të konstatohet se vendimi i Autoritetit Kontraktues për përzgjedhjen e OE INSI Shpk si fitues:

- Është marrë në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së për shkak të mosrespektimit të specifikimeve esenciale;
- Ka shkelur nenin 69 të LPP-së për mungesë të kapacitetit tek-profesional së dëshmuar;
- Ka anashkaluar kriteret për përputhshmërinë me dokumentacionin e tenderit;
- Ka shkelur nenin 72 të LPP-së duke penguar të drejtën për qasje në dokumente.

b. Të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim:

Të shqyrtohet përmbajtja e vlerësimit dhe të urdhërohet rivlerësimi teknik/financiar nga një komision i ri, në përputhje me nenin 59 dhe nenin 108 të LPP-së

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë se si rezultat i shkeljeve ligjore si më sipër, ne na janë shkaktuar dëme të larta financiare, rreth 100mije €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Në bashkëngjitje të Ankesës janë dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- c) një kopje e njoftimit për vendimin e AK.
- d) një kopje e kërkesës për rishqyrtim e datës 27.05.2025
- e) një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se, e datës 30.05.2025
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.